



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:003549

Datë: 01.02.2024

Numri i dokumentit: 05275089

E.nr.2/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË / DEGA MALISHEVË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM– DIVIZIONI CIVIL, Përmbarimore, gjyqtari Nehat Qelaj, në çështjen juridike të përmbarimit të kreditorit R.K, i përfaqësuar nga avokati Agron Kryeziu nga Malisheva, ndaj debitorit Komuna e Malishevës- Drejtoria e Arsimit e përfaqësuar nga avokati publik Mujë Sahitaj, lidhur me përmbarimin e aktgjykimit të kësaj gjykate C.nr.213/2020 të datës 04.06.2021, për kompensim të shujtës ditore, me datën 01.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura e përmbarimit në çështjen përmbarimore të kreditorit R.K, ndaj debitorit Komuna e Malishevës- Drejtoria e Arsimit, për kompensim të shujtës ditore sipas aktgjykimit të kësaj gjykate C.nr.213/2020 të datës 04.06.2021, i plotfuqishëm me date 28.12.2021, dhe i ekzekutueshëm me date 02.02.2022, pasi që është përmbushur detyrimi i debitorit ndaj kreditorit me urdhëresën për përmbarim të kësaj gjykate E.nr.91/2022 të datës 13.02.2023.

A r s y e t i m

Kreditori më datë 11.01.2022 në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tij kanë parashtruar propozimin për përmbarim të aktgjykimit të kësaj gjykate C.nr.213/2020 të datës 04.06.2021, i plotfuqishëm me date 28.12.2021, i ekzekutueshëm me date 02.02.2022, si dhe i vërtetuar me Aktgjykimin nga Gjykata e Apelit në Prishtinë Ac.nr.5203/2021 të datës 28.12.2021, e të cilin kjo gjykatë me aktvendimin E.nr.2/2022 të datës 28.03.2022, e lejon përmbarimin e këtij propozimi. Ndaj këtij vendimi nuk është parashtruar prapësim nga debitori prandaj pas plotfuqishmërisë të këtij aktvendimi, Gjykata me datë 13.02.2023, ka dërguar urdhrin për ekzekutim në Ministrinë e Financave dhe Transfereve - Thesarit të Kosovës, që të bëjnë ndalesën e mjeteve monetare nga llogaria e debitorit në emër të detyrimit ndaj kreditor të përshkruar si në këtë urdhër për ekzekutim.

Debitori-Komuna Malishevës më anë të parashtrësës datës 16.11.2023 njoftoj Gjykatën se për këtë lëndën përmbarimore është kryer përmbarimi nga thesari qendror sipas vendimeve gjyqësore që gjenden në listë (bashkangjitur parashtrësës).

Gjykata pas shikimit të kësaj liste konstaton se Urdhëri për ekzekutim E.nr.2/2022 të datës 13.02.2023 që ka të bëjë me kreditorin është ekzekutuar.

Meqenëse i autorizuari i debitorit përmes parashtrësës së lartë cekur e njoftuan gjykatën se kjo lëndë është ekzekutuar gjykata në kuptim të nenit 66 par.4 të LPP-së vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi .

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
DIVIZIONI CIVIL, Përmbarimore
E.nr.2/2022 datë 01.02.2024**

**Gj y q t a r i
Nehat Qelaj**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij Aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.